

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

**13.04.2021
Ora 16:19**

RENDI I DITËS

Projektudhëzim “Për përdorimin e aplikacionit KQZ”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Me vendimin nr.11, datë 25.03.2021, Komisioni Rregullator ka përcaktuar në nenin 38, pika 5 se anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit dhe operatorët teknik për raportimin, informimin e aspekteve procedurale që lidhen me zbatimin e procesit të punës të përcaktuar në këtë vendim përdorin paralelisht edhe mjetet dhe platformat e ndërveprimit elektronik sipas udhëzimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Referuar kësaj pike të vendimit të Komisionit Rregullator është përgatitur projektudhëzimi “Për përdorimin e programit aplikativ KQZ”. Gjatë ditës së votimit nga anëtarët e Komisionit Qendrës së Votimit dhe Komisionit të Zonës Administrimit Zgjedhor dhe operatorët e KQZ-së të ngarkuar me detyra të posaçme në qendrat e votimit. Nëpërmjet aplikacionit “KQZ”, anëtarët e KQV-së, ose të KZAZ-së dhe sipas rastit operatorët informojnë KQZ-në për ecurinë e votimit ose të numërimit e të nxjerrjes së rezultateve. Është përcaktuar gjithashtu se operatori, ka detyrim për dërgimin çdo një orë të informimit për pjesëmarrjen nëpërmjet “Skano QR Code”, sipas procedurave të përcaktuara në lidhjen 1. Ky informacion mundet të dërgohet në

**Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

KQZ edhe nga secili prej anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit, por në çdo rast pa penguar procesin e votimit dhe përdorimin e PEI nga operatori. Bashkëlidhur keni projektudhëzimin për shqyrtim dhe miratim si dhe lidhjet bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, kemi ndonjë diskutim nga përfaqësuesit e partive politike? Nuk ka. Ky është një akt që sikurse e kemi bërë diskutimin dhe konsultuar dhe me përfaqësues të partive politike, ka për qëllim që t'i krijojmë mundësi anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit por dhe të KZAZ-së një mocion shumë për të dhënë informacion dhe për të dërguar informacion në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në mënyrë kategorike nuk zëvendëson asnjë prej dokumentave zgjedhor apo materialeve tjera zgjedhor që do të përdoren gjatë ditës së votimit. Thjesht është një opsion më shumë.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Duke qenë se ky ka ardhur sot dhe nuk kemi pasur as kohën e mjaftueshme ne që e kemi marrë në email ta shikojmë dhe për të pasur një rakordim pak më të drejtë në lidhje me projektvendimin e propozuar. Do të kërkoja që këtë ta shqyrtonim me një seancë tjetër në një datë sa më të afërme dhe të vimë të përgatitur dhe të jemi pak më të njohur qoftë me udhëzimin e përdorimit edhe me personat kush do të duhet ta përdorë atë ditë, sepse me një sy të shpejtë që kemi parë deri tani. Në pikën 1 i jepet për përdorim operatorit dhe në pikat e tjera nuk përjashtohen as anëtarët e tjerë të QV-ve apo të KZAZ-ve. Ta shikojmë, të njihemi dhe pastaj të japim dhe ne mendimet tona qoftë relatimet edhe para datës që ju do të caktoni dhe të jetë një akt i pranueshëm nga të gjithë dhe më shumë për t'u kuptuar sesi do të funksionojë.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, e shtyjmë vendimmarrjen dhe për këtë pikë të rendit të ditës.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

**15.04.2021
Ora 16:13**

RENDI I DITËS

Projektudhëzim: Përdorimi i aplikacionit KQZ

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PD, LSI, PDIU**
- **Vëzhgues** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Fillojmë seancën, në rendin e ditës janë për shqyrtim projektaktet: Pika e parë projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 37; “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”; pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me Projektvendimin “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes të disa QV-ve, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”; pika e tretë ka të bëjë me Projektvendimin “Për emërimin e sekretarit të KZAZ-së, lirim dhe emërim të sekretarit të KZAZ-së 26 Qarku Tiranë dhe disa anëtarëve të KZAZ-ve”. Pika e katërt është Projektvendimi “Për miratimin e rregullave procedurale e teknike për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit në QV-të e ZAZ-së nr. 40 në Qarkun Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”; pika e fundit është Projektvendimi “Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021”. Nga mbledhja e kaluar

1

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

kemi dhe projektvendimin që ka të bëjë me “Miratimin e procedurave të aplikacionit KQZ”.

Z. Y. Merhaj: Kemi një propozim për të shtuar një pikë në rendin e ditës, është projektvendimi “Për një ndryshim në vendim nr.148 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e vendodhjes së VNV-ve”. Bëhet fjalë për vendodhjen e VNV-së

Z. I. Celibashi: Dakord të shtohet! Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që në fakt ka të bëjë me vazhdimin e shqyrtimit të projektudhëzuesin që ka të bëjë me “Përdorimin e aplikacionit KQZ”. Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës përfaqësuesit e partive politike kanë ndonjë gjë?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Jemi dakord i nderuar lidhur me këtë pikë. Shprehemi dakord pasi u njohëm dhe mendojmë se ky aplikacion është në të mirë të gjithë procesit zgjedhor për atë ditë dhe të gjitha problemeve që mund të reflektojnë në kohë reale. Të cilat ngelen të pasqyruara edhe më vonë për zgjidhjen e problematikave që mund të krijohen në kohë të ankimeve më vonë. Kështu që mendojmë se duhet të kalojë sot ashtu siç akti është parashtruar nga ju, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, diskutime të tjera? Nuk kemi, atëherë meqenëse edhe pas konsultimeve kemi dakordësinë e përfaqësuesve të partive politike në lidhje me projektaktin, Vendos:

Miratimin e udhëzimit sipas të cilit, Komisioneri udhëzon:

1. Përdorimin e programit aplikativ “KQZ” gjatë ditës së votimit, nga anëtarët e KQV-ve, KZAZ-ve dhe operatorët e KQZ-së të ngarkuar me detyra të posaçme në

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

qendrat e votimit, sipas procedurave të përcaktuara në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Përdorimi i aplikacionit “KQZ” nuk i përjashton anëtarët e KQV-së, ose sipas rastit të KZA-së nga detyrimi për përdorimin dhe mbajtjen e çdo dokumentacioni tjetër zgjedhor, si të tilla por pa u kufizuar, libri i protokollit të mbledhjeve të proces-verbale, etj.

3. Nëpërmjet aplikacionit “KQZ”, anëtarët e KQV-ve, ose të KZAZ-ve, si dhe sipas rastit operatorët informojnë KQZ-në për ecurinë e votimit dhe ose të numërimit e të nxjerrjes së rezultatit.

4. Operatori, ka detyrimin për dërgimin çdo një orë të informacionit mbi pjesëmarrjen nëpërmjet “Skano QR Code”, sipas procedurave të përcaktuara në lidhjen 1. Ky informacion mundet të dërgohet në KQZ edhe nga secili prej anëtarëve të KQV-së, por në çdo rast pa penguar procesin e votimit dhe përdorimin e PEI nga operatori.

5. Ngarkohen anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit, të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor dhe operatorët e KQZ-së të ngarkuar me detyra të posaçme në qendrat e votimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Udhëzim nr. 8

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

15.04.2021
Ora 16:19

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 37, “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PD, LSI, PDIU**
- **Vëzhgues:** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Rregullator me vendim nr.14, datë 10.04.2021 në nenin 18, pika 8, të këtij vendimi ka ngarkuar Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, të përcaktojë materialin e dokumentacionit të punës që do të përdorë KZAZ-të dhe Grupet e Numërimit gjatë proceset të numërimit të votave, i cili për shkak të ndryshimeve ligjore sjell që në ndryshim të procedurave në numërim në votën parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore. Në udhëzimin nr. 04, datë 08.03.2021, Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve, ka miratuar dokumentet për mbledhjen, administrimin e rezultatit paraparak të

1

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

zgjedhjeve. Duke qenë se procesverbalet e kërkuara me vendimin nr. 14 të vitit 2021 të Komisionit Rregullator, janë dokumente provuese që shoqërojnë informacionin e përpunuar nga grupet e numwrimit, propozohet nga administrata projektvendimin e mësipërm duke shtuar tre modele të dokumentacionit të punës do të përdoren nga KZAZ-ja dhe anëtarë të Grupeve të Numërimit gjatë procesit të numërimit të votave. Do të doja të propozoja zarfin model 06/1 dhe procesverbalet Model PV KZAZ-29/1 dhe PV KZAZ 31/1. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe modelet e zarfeve që do të përdoren, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Atëherë në vijim të relatimit që bëri sekretari, idea është që sikurse kemi diskutuar dhe kemi vendosur, në fakt e ka vendosur Rregullatori fletët e votimit të vlefshme për subjektin më të cilat ka shënime vetëm për partinë politike ose për koalicionin do të mbyllen në një zarf dhe këto nuk do t'i nënshtrohet një procesi tjetër të rivlerësimit. Kjo për arsye që të evitojmë në një dëshirë të një numëruesi që atë të rezervuarin e votave të partisë ta përdorë për interesa të një kandidati. Kështu që në këtë mënyrë kemi miratuar përdorimin e një zarfi tjetër në të cilën do të vendosen këto fletë votimi ku janë votat vetëm për partinë politike ose për koalicionin dhe nuk ka vota për kandidat dhe këto fletë votimi nuk do të rinumërohen në fazën e dytë. Kemi ndonjë diskutim? Nuk kemi, jemi dakord. Bazuar në nenin 19, pika 1 dhe vijues të Kodit Zgjedhor vendos: Në vendimin nr. 37, datë 17.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021", bëhen këto ndryshime: Në fund të pikës 1.6 shtohet përmbajtja, si më poshtë vijon: Zarfi Model 06/1 për votat e vlefshme për partitë politike dhe koalicionet ku nuk ka votim parapëlqyes

2

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

për kandidatët, formati A2 me përmasat 44 herë 36 cm; Model KZAZ-29/1, Procesverbal për votat e vlefshme për partitë politike dhe koalicionet ku nuk ka votim parapëlqyes për kandidatët, letër e thjeshtë format A4 “Për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve, miratimin e modeleve të tabelave të rezultateve”; Model KZAZ-31/1. Procesverbal përmbledhës për votat e vlefshme për partitë politike dhe koalicionet ku nuk ka votim parapëlqyes për kandidatët, letër e thjeshtë format A4, i cili administrohet sipas procedurave të përcaktuara në nenin 8 të udhëzimit nr. 4 “Për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të tabelave të rezultateve”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 236

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

15.04.2021
Ora 16:23

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes të disa QV-ve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PDIU, LSI, PD**
- **Vëzhgues:** **OSBE/ODIHR**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Neni 62, pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara nga neni 63 i Kodit Zgjedhor, kjo nuk është e mundur. Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshohet në 40 ditët e para të zgjedhjeve përveçse rasteve kur për shkaqe ose forca madhore ndryshimi autorizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për këtë arsye Kryetari i Bashkisë Librazhd ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit numër 2762. Kryetari i Bashkisë Belsh ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit numër 2566 dhe qendrës së votimit 2571. Gjithashtu, ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit 2579, 2583, 2584 dhe 2586. Kryetari i Bashkisë Lezhë ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit numër 720. Kryetari i Bashkisë Mirditë ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit numër 824. Kryetari i Bashkisë Dibër ka

Zbardhi materialin audio

Jopida SALILLARI

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit 1145. Kryetari i Bashkisë Kamzë ka kërkuar ndryshimin e qendrës së votimit numër 1589/1, 2041/3 dhe qendrës së votimit 2048 dhe 2048/1. Kryetari i njësisë administrative Kashar ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit numër 1540, 1540/1, 1540/2. Gjithashtu, Kryetari i njësisë administrative Petrelë ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit 1642, 1634. Njësia Administrative 9, Bashkia Tiranë ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit 1959, 1959/1, 1959/2. Kryetari Bashkisë Tiranë ka kërkuar ndryshimin e vendodhjes së qendrës së votimit 1536, 1536/1, 1536/2. Ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes 1537, 1537/1, 1537/2, 1537/3, 1537/4, 1537/5, 1537/6, 1537/7, 1537/8, 1537/9, 1537/10, 1537/11 dhe 1537/12. Kryetari Bashkisë Divjakë ka kërkuar ndryshimin e vendodhjes së qendrës së votimit numër 2956. Kryetari Bashkisë Patos ka kërkuar ndryshimin e vendodhjes së qendrës së votimit numër 3089. Kryetari Bashkisë Përmet ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit numër 4172. Kryetari Bashkisë Krujë ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit numër 1309. Kryetari Bashkisë Durrës ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit numër 1523. Këto ishin propozimet e kryetarëve të bashkive. Për këto ndryshime të qendrave të votimit është bërë verifikimi nga inspektorët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nga Komisioni i Administrimit të zonës zgjedhore. Si edhe kanë paraqitur dokumentacionet që janë të njëtat me propozimet që kanë bërë kryetarët e bashkive për standard. Ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim projekvendimin e mësipërm.

Z.I.Celibashi: Atëherë, nga verifikimet që KQZ ka bërë bazuar në informacionet e inspektoreve dhe të anëtarëve të KZAZ ose të KZAZ-ve konfirmohen shkaqet mbi të cilat kryetarët e bashkive kërkojnë ndryshimin e qendrës së votimit. Po, përfaqësuesit e partive politike?

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Jemi dakord me të gjitha pjesët e këtyre njësive. Me këto propozimet nga kryetarët e njësive vendore thjesht vetëm një pyetje kemi. Domethënë, duke parë materialin bashkëlidhur që i drejtojmë Administratës në lidhje me ndryshimet e QV-ve në Tiranë. A janë dhënë me konsensus me shkrim nga kryetarët e KZAZ-ve ndryshimet e këtyre apo jo? Pavarësisht se kemi propozimet nga ana e Bashkisë. Pavarësisht se mund t'i kemi edhe siç relatuat ju verifikimet nga inspektorët thjesht për një sqarim.

Z.Y.Merkaj: Nëse më lejon.. është marrë miratimi i KZAZ-ve, përfaqësuesve të KZAZ-ve. Behet fjalë për.. mesa di unë për zonën e Astirit e cila ka qenë në qendrën e votimit me një distancë shumë të largët dhe janë sjellë në rrugën nacionale. Tek.. në Astir është.

Z.I.Celibashi: Faleminderit. Diskutime të tjera? Nuk kemi. Mirë, atëherë meqenëse nuk kemi diskutime të tjera jemi dakord me materialin e referuar. Bazuar në nenin 29, paragrafi 1, shkronja "n" dhe paragrafi 2 dhe neni 62, paragrafi 4, neni 93 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos:

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore të afishojnë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, të caktuara me këtë vendim.
3. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore të rinjoftojnë menjëherë zgjedhësit, për adresën e re të qendrave të votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

Njëkohësisht do të duhet që të bëjmë përditësimin edhe në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe në E-Albania. Po kështu në aplikacion për këto ndryshime. Ndërkohë duhet t'ia nisim zyrtarisht sot kryetarëve të bashkive vendimin me qëllim që të marrin masat për njoftimin dhe për të bërë afishimin e listave të zgjedhësve në këto qendra votimi, sot dakord!

Vendimi nr.237

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

15.04.2021
Ora 16:30

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për lirim dhe emërimin e sekretarit të KZAZ-së nr.26 dhe disa anëtarëve të KZAZ-ve”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PDIU, LSI, PD**
- **Vëzhgues** **OSBE/ODIHR**

Z.I.Celibashi: Mirë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Bazuar në nenin 82, pika 2, shkornja “d” e Kodit Zgjedhor Partia Demokratike ka paraqitur kërkesën për lirim dhe emërimin e sekretarëve të KZAZ-së numër 26. Për lirim dhe emërimin e një anëtari të KZAZ-së numër 26 Qarku Tiranë. Ka kërkuar lirim dhe zvendësimin e anëtarëve të KZAZ-së numër 63 Qarku Berat. Partia Socialiste ka kërkuar lirim dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-së numër 2 Qarku Shkodër, si edhe lirim dhe zvendësimin e anëtarëve të KZAZ-së numër 14 Qarku Lezhë. Partia Socialdemokarte e Shqipërisë ka kërkuar lirim dhe zvendësimin e anëtarëve të KZAZ-së numër 9 Qarku Kukës. Gjithashtu, Partia Socialiste ka kërkuar lirim dhe zvendësimin e anëtarëve të KZAZ-së numër 68 Qarku Berat. Të gjitha propozimet e paraqitura nga partitë politike plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor dhe si

**Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

të tilla duhet të pranohen. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Faleminderit. Përfaqësuesit e partive politike diskutime në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës nuk kanë? Natyrshëm që jo. Atëherë, bazuar në sa u relatua si edhe nenin 19, paragrafi 1, shkronja “ç” dhe 2, nenet 30, 31 dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d” të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos:

- 1.Të liroj nga detyra sekretarin e KZAZ-së numër 26 Qarku Tiranë dhe anëtarët e disa KZAZ-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Të emëroj sekretarin e KZAZ-së numër 26 Qarku Tiranë dhe anëtarët e disa KZAZ-ve sipas lidhjes 2 bashkëlidhur.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së dhe i njoftohet KZAZ- së përkatëse.
- 4.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.238

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

**15.04.2021
Ora 16:31**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e rregullave procedurale teknike të ZAZ nr.40, për administrimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të votimit dhe numërimit elektronik për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PDIU,**
- **Vëzhgues:** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Rregullator me vendimin nr. 17, datë 14.04.2021, ka përcaktuar rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në QV-të e ZAZ-së nr.40 në qarkun Tiranë, për zgjedhjet e Kuvendit, të datës 25 prill 2021. Gjithashtu ka autorizuar dhe Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve të miratojë rregullat procedurale e teknike për procesin e votimit elektronik nëpërmjet pajisjes të votimit dhe numërimit elektronik (PENV) në QV-të e ZAZ-së Nr.40, në Qarkun Tiranë, për Zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021. Projektakti përbëhet nga dy pjesë lidhja nr.1 dhe nga lidhja nr.2. Pjesa e parë ka të bëjë me votimin kur, Pajisja Elektronike e Votimit dhe Numërimit Elektronik (PEVN) ku kryhet votimi elektronik shoqërohet

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021**

nga një kuti e pajisur me printer që mundëson versionin fizik të votës dhe ruajtjen e votës në të. PEVN-ja të ketë dy memorje USB, të veçanta, një për backup, ku do të ruhen elektronikisht “votat” që do të “hedhin” zgjedhësit. Kutia shoqëruese do të ketë 3 kode sigurie. KZAZ-ja i dorëzon KQV-së: PEVN, kutinë shoqëruese me printer dhe bazën e materialeve zgjedhore jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit. Në momentin e mbërritjes së bazës materiale në QV, pranë çdo QV të ketë një person teknik të kontraktuar nga KQZ i cili do të kryejë, në prani të KQV-së, montimin, testimin e pjesëve elektronike dhe pozicionimin e PEVN-ve dhe kutive shoqëruese në ambientin e QV-së. Personi teknik i ngarkuar për përdorimin e PEVN, nëpërmjet kartave smart dhe kodeve përkatës bën hapjen e PEVN-ve duke printuar dhe dorëzuar KQV-së raportin e hapjes së votimit i cili duhet të tregojë veç orës së hapjes, numrit të QV-së dhe të pajisjes edhe 0 pjesëmarrës në votim. Procesin e aktivizimit për votim të dy PEVN-ve në çdo QV e kryen Kryetari i KQV-së, nëpërmjet dy butonave të tipit pulsant, nga një për secilën pajisje. 8. Votuesi do të ketë mundësi të votojë duke përdorur një ekran me prekje i cili është i thjeshtë në përdorim, ka madhësi të mjaftueshme për të shfaqur të gjitha subjektet zgjedhore dhe kandidatët, apo mesazhet e nevojshme gjatë procesit. Votuesi do të ketë mundësi të verifikojë votën e printuar para se ajo të bjerë në kuti duke e parë me sy të lirë pa patur mundësi ta preki votën e printuar e cila sigurohet duke u mbuluar nga material transparent. Në rast se votuesi dëshiron të anullovë votën pasi është printuar, para rënies në kuti të saj, atij do t’i jepet mundësia që ta kryej këtë proces vetëm një herë. Vota e anuluar do të bjerë në kuti dhe në të do të printohet qartësisht mesazhi “e anuluar”. Në se një nga pajisjet për arsye teknike nuk funksionon, votimi vazhdon në pajisjen tjetër deri në riparimin e defektit. PEVN punon e pavarur nga energjia elektrike për 12 orë. Është parashikuar dhe numërimi elektronik dhe në fund tek

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

pjesa e dytë është parashikuar dhe janë dhënë hapat për vënien në punë të PEVN.
Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit. Diskutime nga përfaqësuesit e partive? Nuk kemi.

Mirë, atëherë bazuar në nenin 19 pika 1 dhe vijues të Kodit Zgjedhor vendos:

1.Miratimin e rregullave procedurale teknike të ZAZ nr.40, për administrimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të votimit dhe numërimit elektronik për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga momenti i hyrjes së tij në fuqi.

Vendimi nr.239

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

15.04.2021

Ora 16:36

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një shtesë në vendimin nr.189, datë 29.03.2021 “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë dhe afatshkurtër të Fondacionit “Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PDIU, LSI, PD**
- **Vëzhgues:** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Koalicioni për Reforma dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e 778 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Shoqata për Integrim të Zonave Informale (SHIZI) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 362 (treqind e gjashtë dhjetë e dy) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve (QZHDI) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 24 (njëzet e katër) vëzhguesve afatshkurtër. Fondacioni “KUJTO” i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 143 (njëqind e dyzet e tre) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore (ACQJ) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gazeta Tema i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 3 (tre) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Shoqëria Dosja shpk ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 14

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

(katërmbëdhjetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Fax Media Neës” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Klan” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 25 (njëzet e pesë) gazetarëve. Radio Televizionit Shqiptar ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) gazetarëve. Gazeta “Koha Jonë” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 8 (tetë) gazetarëve. Antena Televizion ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 10 (dhjetë) gazetarëve. Fondacioni “Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve” (INSIZ) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 22 (njëzet e dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 20 (njëzet) vëzhguesve afatshkurtër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2/2021 të KQZ, “Për akreditimin e vëzhguesve”. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit. Diskutime nga përfaqësuesit e partive? Nuk kemi. Mirë, mqs nga sa u relatua nga sekretari dokumentacioni që ka shoqëruar kërkesat për akreditim të vëzhguesve është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor vendos:

1. Në vendimin 189 datë 29.03.2021 "Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë dhe afatshkurter të fondacionit Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve (INSIZ) për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021" të bëhet shtesa si më poshtë:

2. Në listën e përcaktuar në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit 189, të shtohen 22 (njëzet e dy) vëzhgues afatshkurtër.

Vendimi nr.240

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

15.04.2021
Ora 16:36

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PDIU**
- **Vëzhgues:** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Koalicioni për Reforma dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e 778 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Shoqata për Integrim të Zonave Informale (SHIZI) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 362 (treqind e gjashtë dhjetë e dy) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve (QZHDI) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 24 (njëzet e katër) vëzhguesve afatshkurtër. Fondacioni “KUJTO” i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 143 (njëqind e dyzet e tre) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore (ACQJ) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gazeta Tema i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 3 (tre) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Shoqëria Dosja shpk ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 14

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

(katërmbëdhjetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Fax Media Neës” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Klan” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 25 (njëzet e pesë) gazetarëve. Radio Televizionit Shqiptar ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) gazetarëve. Gazeta “Koha Jonë” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 8 (tetë) gazetarëve. Antena Televizion ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 10 (dhjetë) gazetarëve. Fondacioni “Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve” (INSIZ) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 22 (njëzet e dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 20 (njëzet) vëzhguesve afatshkurtër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2/2021 të KQZ, “Për akreditimin e vëzhguesve”. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit. Diskutime nga përfaqësuesit e partive? Nuk kemi. Mirë, mqs nga sa u relatua nga sekretari dokumentacioni që ka shoqëruar kërkesat për akreditim të vëzhguesve është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor vendos:

1. Të miratojë kërkesën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës për akreditimin e 20 (njëzet) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Vendimi nr.241

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

15.04.2021
Ora 16:36

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve të Koalicionit për Reforma dhe Institucione të Konsoliduara, Shoqatës për Integrim të Zonave Informale, Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve dhe Fondacionit “Kujto”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PDIU, LSI, PD**
- **Vëzhgues:** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Koalicioni për Reforma dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e 778 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Shoqata për Integrim të Zonave Informale (SHIZI) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 362 (treqind e gjashtë dhjetë e dy) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve (QZHDI) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 24

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

(njëzet e katër) vëzhguesve afatshkurtër. Fondacioni “KUJTO” i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 143 (njëqind e dyzet e tre) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore (ACQJ) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gazeta Tema i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 3 (tre) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Shoqëria Dosja shpk ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 14 (katërmbëdhjetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Fax Media Neës” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Klan” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 25 (njëzet e pesë) gazetarëve. Radio Televizionit Shqiptar ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) gazetarëve. Gazeta “Koha Jonë” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 8 (tetë) gazetarëve. Antena Televizion ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 10 (dhjetë) gazetarëve. Fondacioni “Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve” (INSIZ) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 22 (njëzet e dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 20 (njëzet) vëzhguesve afatshkurtër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2/2021 të KQZ, “Për akreditimin e vëzhguesve”. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit. Diskutime nga përfaqësuesit e partive? Nuk kemi. Mirë, mqs nga sa u relatua nga sekretari dokumentacioni që ka shoqëruar kërkesat

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

për akreditim të vëzhguesve është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor vendos:

- 1.Të miratojë kërkesën e Koalicioni për Reforma dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) për akreditimin e 778 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
- 2.Të miratojë kërkesën e Shoqatës për Integrim të Zonave Informale (SHIZI) për akreditimin e 362 (treqind e gjashtëdhjetë e dy) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi;
- 3.Të miratojë kërkesën e Qendrës për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve (QZHDI) për akreditimin e 24 (njëzet e katër) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë,të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes 3 bashkëlidhur këtij vendimi;
- 4.Të miratojë kërkesën e Fondacionit “KUJTO” për akreditimin e 143 (njëqind e dyzet e tre) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë,të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes 4 bashkëlidhur këtij vendimi.

Vendimi nr.242

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

15.04.2021
Ora 16:36

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e gazetarëve dhe operatorëve të Qendrës Shqiptare për Gazetari Cilësore, gazeta Tema, Shoqëria Dosja sh.p.k, Fax Media News, Tv Klan, Radio Televizioni Shqiptar, gazeta “Koha Jonë”, Antena Televizion, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PDIU, LSI, PD**
- **Vëzhgues:** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Koalicioni për Reforma dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e 778 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Shoqata për Integrim të Zonave Informale (SHIZI) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 362 (treqind e gjashtë dhjetë e dy) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve (QZHDI) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 24 (njëzet e katër) vëzhguesve afatshkurtër. Fondacioni “KUJTO” i ka paraqitur

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

KQZ-së kërkesën për akreditimin e 143 (njëqind e dyzet e tre) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore (ACQJ) i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gazeta Tema i ka paraqitur KQZ-së kërkesën për akreditimin e 3 (tre) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Shoqëria Dosja shpk ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 14 (katërbëdhjetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Fax Media Neës” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Klan” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 25 (njëzet e pesë) gazetarëve. Radio Televizionit Shqiptar ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) gazetarëve. Gazeta “Koha Jonë” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 8 (tetë) gazetarëve. Antena Televizion ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 10 (dhjetë) gazetarëve. Fondacioni “Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve” (INSIZ) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 22 (njëzet e dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 20 (njëzet) vëzhguesve afatshkurtër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2/2021 të KQZ, “Për akreditimin e vëzhguesve”. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit. Diskutime nga përfaqësuesit e partive? Nuk kemi. Mirë, mqs nga sa u relatua nga sekretari dokumentacioni që ka shoqëruar kërkesat për akreditim të vëzhguesve është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor vendos:

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

- 1.Të miratojë kërkesën e Qendrës Shqiptare për Gazetari Cilësore (ACQJ) për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve;
- 2.Të miratojë kërkesën e Gazetës Tema për akreditimin e 3 (tre) gazetarëve;
- 3.Të miratojë kërkesën e Shoqërisë Dosja shpk për akreditimin e 14 (katërbëdhjetë) gazetarëve;
- 4.Të miratojë kërkesën e Televizionit “Fax Media News” për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve;
- 5.Të miratojë kërkesën e Televizionit “Klan” për akreditimin e 25 (njëzet e pesë) gazetarëve;
- 6.Të miratojë kërkesën e Radio Televizionit Shqiptar për akreditimin e 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) gazetarëve;
- 7.Të miratojë kërkesën e Gazetës “Koha Jonë” për akreditimin e 8 (tetë) gazetarëve dhe operatorëve;
- 8.Të miratojë kërkesën e Antena Televizion për akreditimin e 10 (dhjetë) gazetarëve dhe operatorëve.

Vendimi nr.243

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

**15.04.2021
Ora 16:41**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 148, datë 16.03.2021 “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PDIU, LSI, PD**
- **Vëzhgues:** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me Vendimin nr. 148, datë 16 Mars 2021, ka caktuar Vendin e Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”, bashkëlidhur lidhjes 1 të këtij vendimi është dhe përcaktimi i vendit të numërimit të votave të KZAZ-së nr.71,Qarku Korçë, në Qëndrën Shëndetësore Pustec. Prefekti i Qarkut Korçë datë 15.04.2021, ka dërguar kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së VNV-së nr.71, nga Qendra Shëndetsore Pustec në katin e parë të Shkollës së Mesme të Përgjithshme Pustec. Ambienti i propozuar, plotëson kriteret e parashikuara në Vendimin nr.3 të KQZ-së, pasi ka 7 QV, dhe ambienti i propozuar ka hapësirë të mjaftueshme për të zhvilluar procesin e numërimit të votave, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

Z. I. Celibashi: Faleminderit. Diskutime nga përfaqësuesit e partive? Nuk kemi. Mirë, atëherë bazuar në nenin 19, paragrafit 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” vendos:
1.Në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit nr. 148, datë 16 Mars 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, bëhet ndyshimi si më poshtë vijon:
a)Në Qarkun Korçë, në KZAZ-në nr.71, objekti i propozuar për VNV “Qendra Shëndetësore Pustec”, zëvendësohet me, Salla kati parë, Shkolla e Mesme e Përgjithshme” Pustec.
2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së;
3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.
Çështje të tjera jashtë rendit të ditës nuk kemi, faleminderit të gjithëve për kontributet dhe seanca mbyllet.

Vendimi nr.244

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*

